

## L I G J

Nr. 8987, datë 24.12.2002

### PËR KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR NDËRTIMIN E BURIMEVE TË REJA TË PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### K U V E N D I

#### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### V E N D O S I:

##### Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve lehtësuese, deri në liberalizimin e plotë të çmimit të energjisë elektrike, për çdo person juridik vendas dhe të huaj, që do të ndërtojë burime të prodhimit të energjisë elektrike.

##### Neni 2

Çdo person juridik vendas dhe i huaj, që do të ndërtojë burime të prodhimit të energjisë elektrike me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW për burim, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta ose të ngurta dhe pa kufizim për burimet e tjera të rinovueshme të prodhimit, përjashtohet nga taksat doganore për makineritë dhe pajisjet, që bëjnë pjesë në objektin e prodhimit të energjisë elektrike.

##### Neni 3

Çdo personi juridik vendas dhe i huaj, që ndërton burime të prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji, i rimbursohet kundërvlefata e paguar për taksat doganore dhe akcizat e lëndëve djegëse të lëngëta ose të ngurta të përdorura për sasinë e energjisë së shitur, duke marrë në konsideratë konsumin specifik të teknologjisë së zbatuar.

Rimbursimi i taksës doganore dhe akcizës së lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike, bëhet çdo 45 ditë.

#### Neni 4

Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike miraton marrëveshjen e shitjes së energjisë elektrike ndërmjet personave juridikë vendas dhe të huaj, që do të stimulohen për prodhimin e energjisë elektrike, sipas këtij ligji, me Kompaninë Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) ose konsumatorët e kualifikuar.

#### Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3664, datë 14.1. 2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Alfred Moisiu.